



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT
DREJTORIA E VLERËSIMIT TË ANKESAVE**

Nr. 753/4 prot.

Tiranë, më 15.04.2025

VENDIM

Nr. 04, datë 15.04.2025

PËR

RRËZIMIN E ANKESËS

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar,

KONSTATOVA SE:

Ankuesi, Qendra “Res Publica”, përfaqësuar nga z. Dorian Matlija, ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “Komisioneri”), Formularin e Ankesës nr. 753 Prot., datë 20.02.2025, me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare”, kundër Autoritetit Publik/Bashkia Himarë (në vijim, “Autoriteti Publik”).

Ankuesi, nëpërmjet email-it datë 29.01.2025, depozituar në adresën elektronike info@himara.gov.al dhe erindhabili@gmail.com, ka kërkuar t’i vihet në dispozicion dokumentacioni në lidhje me:

Kopje të dokumentacionit shoqërues të vendimit Nr. 34, Prot.1021/1, datë 30/3/2022 “Leje infrastrukture”, konkretisht:

- Preventivi i punimeve,
- Plani i vendosjes së strukture,
- Grafiku i punimeve,
- Miratim për VNM paraprake,
- Raport i VNM,
- Raporti teknik,
- Deklarata e projektuesit të licencuar inxhinier mjedisi,
- Leje përdorimi burimi ujor nga AMBU,
- Marrëveshje investimi RËSP IV,

- Oponenca teknike e projektit,
- Relacion tekrim RËSP IV Lo,
- Harta hidrogeologjike,
- Prerja hidrogeologjike,
- Planimetria e kaptazhit Burimi i Lepushes,
- Studim hidrogeologjik,
- Vendimi dhe Oponenca e Sherbimit Gjeologjik Shqiptar,
- Marrëveshje paraprake investimi Bashkia Himare dhe FSHZH,
- Projekti teknologjik,
- Deklarata e projektuesit të licencuar inxhinier hidroteknik,
- Licensa profesionale,
- Polica e sigurimit te projektit,
- Autorizimin per aplikuesin,
- Dokument vertetues per pronat publike te shtrirjes se projektit,
- Raport mbi impaktin social dhe ambiental,
- Formati i aplikimit, i nënshkruar elektronikisht

Në mungesë të një përgjigje nga Autoriteti Publik, ankuesi, me pretendimin se është cenuar në të drejtën për informim, ka paraqitur ankim pranë Komisionerit duke i kërkuar ushtrimin e kompetencave që i njeh ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit.

Komisioneri pas shqyrtimit paraprak të ankesës, bazës ligjore dhe rrethanave të faktit të paraqitura në të, vlerësoi se ankesa përmbush kriteret formale ligjore, të përcaktuara në nenin 24 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar (në vijim “LDI”).

Në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, Komisioneri, me shkresën nr. 753/1 prot., datë 26.02.2025 ka kërkuar nga Autoriteti Publik të informohet mbi trajtimin apo procedurën e ndjekur lidhur me kërkesën për informacion, si dhe sqarime për zotërimin e dokumentacionit të kërkuar.

Autoriteti Publik me anë të shkresës nr. 1957/1, datë 10.03.2025 si dhe email-it datë 21.03.2025, ka kthyer përgjigje duke sqaruar se: *“...çështja për të cilën kërkoni informacion është duke u gjykuar pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Lushnjë, në gjykimin e padisë Nr.2616 Akti ...”*

Në vijim të përgjigjes së sipërcituar, ankuesi, me anë të email-it datë 26.03.2025, ka vijuar me ankimin pranë Komisionerit, duke pretenduar se: *“Ky arsyetim i autoritetit publik është i pabazuar në ligj. ...Së dyti, autoriteti publik me shkresën e tij na informon se ka një proces gjyqësor që lidhet me informacionin e kërkuar nga ana jonë duke na ftuar të bëhemi pjesëmarrës në proces por në asnjë rast nuk ka refuzuar dhënien e informacionit për shkak të ndonjë rasti kufizimi siç parashikohet në nenin 17 të ligjit “Për të drejtën e informimit”...*

...Për sa më sipër, duke qenë se autoriteti publik nuk ka përmbushur detyrimin për dhënien e informacionit sipas objektit të kërkesës, kërkojmë vijimin e ankimit dhe

detyrimin e autoritetit publik, për të vënë në dispozicion informacionin sipas objektit të kërkesës...”

Sa më sipër, pas konsultimit të legjislacionit përkatës, dokumentacionit të administruar gjatë shqyrtimit administrativ, si dhe fakteve të evidentuara në ankesë, Komisioneri vlerëson se, qëndrimi i Autoritetit Publik është në përputhje me dispozitat e LDI, si dhe detyrimet që burojnë nga ky i fundit.

Nga shqyrtimi i çeshtjes rezulton se, informacioni i kërkuar, në parim përbën informacion publik në kuptim të pikës 2, të nenit 2, të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar. Por, në rastin konkret e drejta e informimit kufizohet në përputhje me shkronjën dh) të pikës 2 të nenit 17, të këtij ligji, në të cilin parashikohet se: *2.E drejta e informimit kufizohet në rast se është e domosdoshme, proporcionale dhe nëse dhënia e informacionit shkakton një dëm të qartë dhe të rëndë ndaj interesave të mëposhtëm: ... “dh) barazinë e palëve në një proces gjyqësor dhe mbarëvajtjen e procesit gjyqësor”.*

Fakt ky i rikonfirmuar nga Autoriteti Publik nëpërmjet email-it datë 07.04.2025, ku sqaron se: *“Dokumentacioni i kërkuar nga ana e shoqërisë “Res Publica”, sic dhe është kthyer përgjigje, është pjesë e shqyrtimit gjyqësor.”*

Ky qëndrim i Komisionerit, gjen mbështetje edhe në ligjin nr. 45/2022 për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Evropës “Për aksesin në dokumente zyrtare”. Në nenin 3 të Konventës *Tromsø*, si instrumenti i parë juridik ndërkombëtar që njeh një të drejtë të përgjithshme të qasjes efektive në dokumentet publike të mbajtura nga autoritetet publike në vendet e Këshillit të Evropës, parashikohet se: *“Secila palë mund të kufizojë të drejtën e aksesit në dokumente zyrtare. Kufizimet duhet të përcaktohen saktësisht në ligj, të jenë të nevojshme në një shoqëri demokratike dhe të jenë proporcionale me për qëllime të mbrojtjes së: ... i) barazisë së palëve në procedimet gjyqësore dhe administrimit të efektshëm të drejtësisë; ...”*

Ndërkohë, nga ana tjetër, Komisioneri vlerëson se, duke qënë se ky dokumentacion, i shërben një procesi gjyqësor, ai duhet aksesuar sipas ligjit nr. 8116, datë 29.3.1996 “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar. Ky legjislacion, në kreun V të tij, parashikon rregulla të përgjithshme për marrjen e provave.

Për rrjedhojë, në lidhje me ankesën e Qendres “Res Publica”, kundër Autoritetit Publik/Bashkia Himarë, Komisioneri vlerëson se informacioni/dokumentacioni objekt shqyrtimi, nuk mund të vihet në dispozicion për shkak të kufizimit të arsyetuar më sipër.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në shkronjën c), të pikës 5 të nenit 24, nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr. 49/2012 “Për Gjykatat Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative”, i ndryshuar,

V E N D O S A:

1. Rrëzimin e ankesës nr. 753 Prot., datë 20.02.2025, të Qendres “Res Publica”, përfaqësuar nga z. Dorian Matlija, kundër Autoritetit Publik/Bashkia Himarë, me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare”.
2. Kundër këtij vendimi pala ka të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni, sipas nenit 25 të ligjit nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar.
3. Ky vendim u shpall sot në datë 15.04.2025.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi